



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POLIÇAN
NJESIA E PROKURIMIT

Nr. ___Prot

Data, __. __. 2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i Procedurës:

BLERJE KAMIONCIN DHE FADROM DHE NEVOJAT E BASHKISE POLIÇAN

Kodi Përkatës

në Fjalorin e Përbashkët

të Prokurimit (CPV): Kamionçina 34136200-1

Vlera e Fondit Limit: : 5 000 000 (pese milion) leke pa tvsh

Burimi i financimit: **nga buxheti i bashkise Poliçan per vitin 2024**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor **Bashkia Poliçan** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; I ZBATUESHEM

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26 dhe nenit 29, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas percaktimeve të bera në Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit).

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8. Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, në marrëveshjen e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht, duhet të përcaktohen saktë përqindja e pjesëmarrjes së shërbimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Keto kritere vërtetojnë se operatorët ekonomikë kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2020, 2021, dhe 2022**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës.

Argumentimi: Ky kriter, është vendosur në perputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, "Per Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar;*

Si dhe në nenin 43 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe nenin 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku përcaktohet se *4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.*

Vendosja e këtyre kritereve bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara me poshtë, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 4 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave,

2.2.2 Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2023 te leshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB. (Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksas vendore 2023 per secilin operator).

Argumentimi: Ky kriter eshte percaktuar bazuar ne ligjinnr.162/2020 date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", neni 76 per kriteret detyruese per skualifikim, si dhe Ligjit nr.Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar

kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme :

- a) Dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Realizimin me sukses i një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik" ,ne te cilin gjejmë te percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4/b te nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilin eshte e percaktuar se: [...]Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat ethjeshtuara duhet të jetë:b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 4/b të nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se **20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

3.1-a)-Operatori ekonomik duhet të deklarojë skeden teknike ose katalogun përkatës të mjeteve dhe me foto në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e parametrave teknike kryesore të mjetit me parametrat teknike të kërkuara nga AK.

3.1.b)-Në momentin e dorëzimit mjeti duhet të jetë i lirë për të qarkulluar në territorin e Republikës së Shqipërisë (i zhdoganuar sipas legjislacionit doganor në fuqi dhe i lirë nga detyrimet përkatëse fiskale), për të përmbushur këtë pikë ofertuesi duhet të paraqesë vetëdeklarim përkatës që për mallin e ofruar nuk ka detyrime fiskale/tatimore që rrjedhin nga dispozitat e legjislacionit përkatës doganor e rrugor në Republikën e Shqipërisë .

3.2-c) Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të marrë përsipër të furnizojë/transportojë dhe të dorëzojë mallin objekt kontrate, në vendet e përcaktuara nga ana e Bashkisë Poliçan me mjetet e tij që ka në dispozicion sipas kërkesës së AK, brenda afatit të levrimit . (kjo pikë në fazën e ofertimit plotësohet nëpërmjet një Deklarate të leshuar nga Administratori i shoqërisë).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 77, pika 4 ku përcaktohet se ”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.”

– Shenim: Në zbatim të nenit 82.5 të Ligjit nr 162/2020 “Per Prokurimin Publik” dhe të pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2022, ku parashikohet : “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit të renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin...”, sjellim në vëmendje se:

- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit të operatorit fitues para lidhjes së kontratës , në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

SPECIFIKIME TEKNIKE PER FADROME CATERPILLAR432D OSE EKVIVALENTE

1. Fadrome me goma, me ngakues para me hapje , dhe krah gerrmimi mbrapa me zgjatues.
2. Viti prodhimit 2002 e lart.
3. Ore pune jo me shume se 10 000 ore /pune
4. Me dokumenta te rregullta shqiptare

MOTORRI

1. Diesel
2. 4 cilindra dhe kapacitet 4.4litra ose 4400kubic
3. Fuqia 55kw/ 75Hp
4. Aspirimi turbo
5. Ftohje me uje

TRASMESIONI

1. Kambio automatike
3. Shpejtesi maksimale 40km/ore ecje para 40 km/ore ecje mbrapa
4. Me 2 diferenciale 4x4
5. Diferencialet te punojn ne menyre te pavavrur dhe dyfishe, AUTO/ 2WD.

AGREGATET.

1. Kove ngarkimi para shume funksionale me hapje te dyfishte me hapje hidraulik gjeresi 235cm, kapacitet $> 1m^3$.
2. Krah teleskop mbrapa gjatesi 4.3m dhe kur zgjatet ne menyre Hidraulike te arrije 5.3m paisur me kove gerrmimi, gjatesia600cm/ kapaciteti kovos $> 0,25m^3$, kove skarpate , kove hapje kanalesh si dhe te kete linje cekici
3. Sistemi hidraulik te jete i plote dhe preciz per kapacitetin e mjetit dhe I lehte ne perdorim.
4. Te kete stabilizues hidraulik per mjetin kur punon me krahun mbrapa.

5. Gomat duhet te jene te brandeve te njohura(ce) dhe te jene 80% te reja jo me shume se 20% te konsumuara

GABINA

1. Gabina e mjetit duhet te jete me kushte optimale per manovrarorin dhe me te gjitha aparaturat e nevojshme per qarkullim dhe targim
2. Te kete ndricim te mjaftushem per punime ne darke, dhe sinjalistike korrekte per udhetim ne rruge urbanistike
3. te kete 6 drita perpara ,4 drita mbrapa

KOPLETIME

1. Celes kuadri plus kopjo

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- **SPECIFIKIME TEKNIKE PER KAMIONCINE**

Lloji i automjetit Kamioncine veteshkarkuese (pas dhe anash) Benx ose ekuivalente me te

- Viti i prodhimit min viti 1990
 - Lloji i lëndes djegëse nafte
 - Numri i vendeve 5+1
 - Numri i dyerve 3
 - Numri i cilindrave 4
 - Numri I akseve 2
 - Fuqia (kw) min 65
 - Pesha mbajttese MBI 3 TON
 - Nr i kilometrave -jo me shume 350 000 km
 - karrocera te jete me super sponde jo me pak se 15 cm.
 - me dokumenta te rregullta shqiptare
 - gomat duhet te jene dopio gome me te vogla se 16 , te brandeve te njohura(ce) dhe te jene 80% te reja jo me shume se 20% te konsumuara
 - te kete sinjalistike te pershtatshme per udhetim.
1. Kambio manual
 2. 5 marshe
 3. Shpejtesi maksimale 120 km/h
 4. Me 1diferenciale 4x2
 5. Te jete e pajisur me tahograf

MOTORRI

1. Diesel
2. 4 cilindra
3. Fuqia jo me pak se 88.32 hp
4. Aspirimi
5. Ftohje me uje

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ANETARET E NJESISE SE PROKURIMIT